



Posta e Kosovës SH. A.
FILATELIA E POSTËS SË KOSOVËS
SHPLL KONKURS

për dizajne artistike të motiveve për pulla postare dhe blloqe filatelike për programin e rregullt të pullave postare për vitin 2018

Në kuadër të programit vjetor 2018 të pullave postare do të përzgjidhen dizajnet më të bukura për emisionet si vijojnë më poshtë:

1. Tematika e emisionit: ***"Qytetet e Kosovës - Gjilani"***.
Përshkrimi: **Paraqitje artistike e qytetit të Gjilanit (grafikë, fotografi artistike, pikturë, vizatim etj.)**.
Shpërblimi: **Vendi i parë €400; vendi i dytë € 300.**
2. Tematika e emisionit: ***"70 vjetori i ansambllit të këngëve dhe valleve 'Shota'"***.
Përshkrimi: **Paraqitja artistike nga veprimtaria (pikturë, vizatim, grafikë, apo foto artistike)**.
Shpërblimi: **Vendi i parë €400, vendi i dytë €300.**
3. Tematika e emisionit: ***"Dëshmorët: Bekim Berisha, Bedri Shala, Nazim Gafurri, Stakë Mark Mirëdita"***.
Përshkrimi: **Prezantim artistik i dëshmorëve (pikturë, fotografi artistike, grafikë)**.
Shpërblimi: **Vendi i parë €400; vendi i dytë €300; vendi i tretë €200.**
4. Tematika e emisionit: ***"Evropa 2018 - Urat"***.
Përshkrimi: **Paraqitja artistike e urave në Kosovë (pikturë, grafikë, apo fotografi artistike)**.
Shpërblimi: **Vendi i parë €400; vendi i dytë €300; blloku filatelik €500.**
5. Tematika e emisionit: ***"Personalitetet e shquara: Fehmi Agani, Azem Shkreli, Anton Pashku, Ejup Statovci"***.
Përshkrimi: **Paraqitja artistike (vizatim, pikturë, grafikë, apo foto artistike)**.
Shpërblimi: **Vendi i parë € 400; vendi i dytë € 300; vendi i tretë € 200, vendi i katërt €170.**
6. Tematika e emisionit: ***"Kampionati botëror i futbollit 2018"***.
Përshkrimi: **Paraqitja artistike që simbolizon kampionatin e futbollit 2018 (vizatim, pikturë, grafikë)**.
Shpërblimi: **Vendi i parë € 400; vendi i dytë € 300; blloku filatelik € 500.**
7. Tematika e emisionit: ***"Arti vizual - Ibrahim Kodra"***.
Përshkrimi: **Paraqitja artistike e veprimtarisë (vizatim, pikturë, fotografi, grafikë)**.
Shpërblimi: **Vendi i parë € 400; vendi i dytë € 300; vendi i tretë € 200; vendi i katërt €170.**

8. Tematika e emisionit: **"10 vjetori i Pavarësisë së Kosovës"**.
Përshkrimi: **Paraqitja artistike (pikturë, fotografi, vizatim, grafikë etj.)**.
Shpërblimi: **Vendi i parë € 400.**
9. Tematika e emisionit: **"Flora - lulet: Manushaqja e Dukagjinit (Viola Dukadjevica), Ylli i Alpeve (Leontopodium alpinum), Shafran crocusflaves Watson, Adonisi fryt-vogël (Adonis microcarpa DC), Barpezmi me mburojë (Achilea clypeolata)**.
Përshkrimi: **Paraqitja artistike e luleve (pikturë, vizatim, grafikë me ngjyra apo fotografi artistike)**.
Shpërblimi: **Vendi i parë €400; vendi i dytë €300; vendi i tretë €200; vendi i katërt €170, vendi i pestë €150.**
10. Tematika e emisionit: **"Fauna - zogjtë e Kosovës"**.
Përshkrimi: **Paraqitje artistike e llojeve: Cerloi i zi pikalosh (sturnus vulgaris), Kredhaku i madh ujqor (Podiceps cristatus), Skifteri thetrazi (malco tunnunculus), Bengu (Oriolus), Turtullesha (Streptopelia tutur) dhe Pupëza (Upupa epops) - (vizatim, grafikë, fotografi artistike, pikturë)**.
Shpërblimi: **Vendi i parë €400; vendi i dytë €300, vendi i tretë €200; vendi i katërt €170, vendi i pestë €150.**
11. Tematika e emisionit: **"20 vjetori i Lavdisë - Familja Jashari"**.
Përshkrimi: **Paraqitje artistike e qëndresës dhe luftës heroike të familjes Jashari (vizatim, grafikë, fotografi artistike, pikturë)**.
Shpërblimi: **Vendi i parë €400; vendi i dytë €300.**
12. Tematika e emisionit: **"Trashëgimia - Lokaliteti antik i Dresnikut"**.
Përshkrimi: **Paraqitje artistike të zbulimeve arkeologjike në Dresnik (vizatim, grafikë, fotografi artistike, pikturë)**.
Shpërblimi: **Vendi i parë €400; bllok filatelik €500.**
13. Tematika e emisionit: **"Artizanati - punime nga argjila"**.
Përshkrimi: **Paraqitje artistike e punimeve nga argjila (vizatim, grafikë, fotografi artistike, pikturë)**.
Shpërblimi: **Vendi i parë €400; vendi i dytë €300, vendi i tretë €200.**

RREGULLAT E KONKURRIMIT:

- Dizajnët artistike të bazuara në këto tema duhet të punohen në programe të specializuara për dizajn (Adobe Photoshop, Illustrator, Corel Draw, apo pamje nga piktura, fotografi, vizatime personale etj, të përpunuara grafikisht); të njëjtat duhet të dorëzohen të shtypura dhe në fajll kompjuterik. Punimet me rezolucion më të ultë se **500 px**. (TIFF ose PDF) nuk pranohen.
- Emri i autorit të dizajnit nuk duhet të shënohet pranë motivit konkurrues, aty duhet të duket vetëm shifra.
- Dizajnet konkurruese për këtë konkurs duhet të dorëzohen në zarfe të mbyllura.
- Një autor mund të konkurrojë me numër të pacaktuar të punimeve, mirëpo me shifra të ndryshme për secilin emision.
- Punimet e printuara konkurruese me CD vendosen në zarf, i cili duhet të përmbajë edhe zarfin e mbyllur me shënimet personale të autorit.

➤ Punimet konkurruese për emisione të ndryshme duhet pakëtuar veçmas, duke e shënuar mbi zarf titullin e emisionit për të cilin konkurroni dhe shifrën.

➤ Përgjegjësinë mbi të drejtat autoriale e mban autori i dizajnit (konkurruesi).

Për shkaqe të konfidencialitetit dhe për shkak të objektivitetit, në pjesën e jashtme të zarfeve dhe në CD duhet të shënohet vetëm shifra e zgjedhur nga vet autori (askund në punime nuk duhet të duket emri apo mbiemri i autorit, vetëm shifra).

Komisioni i Pullës Postare, gjatë përzgjedhjes së dizajneve nuk do të ketë qasje në shënime autoriale, por ka të drejtë të verifikojë mbi origjinalitetin e dizajneve të përzgjedhur.

PK Sh.A. do të bartë obligimet tatimore.

KONKURSI do të jetë i hapur 40 ditë kalendarike, prej datës: 20.09.2017 deri 30.10.2017 dhe do të jetë i publikuar në ueb faqen: www.postakosoves.com.

Punimet konkurruese nuk do t'iu kthehen autorëve.

Zgjedhjen e punimeve më të mira konkurruese, duke u bazuar në dizajnin më të mirë dhe ndarjen e shpërblimeve do ta bëjë Komisioni i Pullës Postare.

Punimet duhet dorëzuar, apo dërguar në këtë adresë:

FILATELIA

Për Konkurs-Filateli

Ndërtesa e Postës së Kosovës p.n.

Fushë Kosovë 12000

Republika e Kosovës

Për informata shtesë mund të thirrni në numrin e telefonit: **+381(0)38 246 770**, apo të na drejtoheni në e-mail adresë: ptkfilatelia@ptkonline.com, ose në ueb faqen zyrtare www.postakosoves.com.



**Pošta Kosova A.D.
FILATELIJA POŠTE KOSOVA
OBJAVLJUJE KONKURS**

za umetnički dizajn poštanskih marki sa motivima i filatelističke blokove, za redovan program poštanskih marki za 2018. godinu.

U okviru programa poštanske marke iz 2018. godine biće izabrani najljepši dizajni za program kao što sledi:

1. Tematska poštanska marka: **"Gradovi Kosova - Gnjilane"**

Opis: Umetnička reprezentacija grada Gnjilana (grafika, umetnička fotografija, slikarstvo, crtež itd.). Nagrada: prvo mesto 400 €; drugo mesto 300 €.

2. Tematska poštanska marka: **"70. godišnjica pesme i plesnog ansambla "Shota"**.

Opis: Umetnička reprezentacija aktivnosti (slikarstvo, crtež, grafika ili umetnička fotografija).
Nagrada: prvo mesto 400 €; drugo mesto 300 €.

3. Tematska poštanska marka: **"Mučenici: Bekim Berisha, Bedri Shala, Nazim Gafurri i Stakë Mirëdita"**.

Opis: Umetnička reprezentacija mučenika (slikarstvo, umetnička fotografija, grafika).
Nagrada: Prvo mesto € 400; drugo mesto 300 €; treće mesto 200€.

4. Tematska poštanska marka: **"Mostovi - Evropa 2018"**.

Opis: Umetnička reprezentacija mostova (slika, grafika ili umetnička fotografija).
Nagrada: Prvo mesto € 400; drugo mesto 300 €; filatelistički blok 500 €.

5. Tematska poštanska marka: **"Značajni ličnosti: Fehmi Agani, Azem Shkreli, Anton Pashku i Ejup Statovci"**.

Opis: Umetnička reprezentacija (crtež, slikarstvo, grafika ili umetnička fotografija).
Nagrada: Prvo mesto € 400; drugo mesto 300 €; treće mesto 200 €; četvrto mesto 170 €.

6. Tematska poštanska marka: **"Svetski kup 2018"**

Opis: Umetnička reprezentacija koja simbolizuje prvenstvo u fudbalu 2018. Godine (crtež, slikarstvo, grafika).
Nagrada: Prvo mesto € 400; drugo mesto 300 €; filatelistički blok 500 €.

7. Tematska poštanska marka: **"Vizuelna umetnost - Ibrahim Kodra"**.

Opis: Umetnička reprezentacija aktivnosti (crtež, slikarstvo, umetnička fotografija, grafika).

Nagrada: Prvo mesto € 400; drugo mesto 300 €; treće mesto 200 €; četvrto mesto 170 €.

8. Tematska poštanska marka: **"Deseta godišnjica nezavisnosti Kosova"**.

Opis: Umetnička reprezentacija (slikarstvo, umetnička fotografija, crtež, grafika itd.)

Nagrada: Prvo mesto € 400.

9. Tematska poštanska marka: **"Flora – Dukađini Ljubičica (Viola Ducadjinika), Runolist (Leontopodium alpinum), Žuti šafran (Saffron Crocus Flavus Watson), Adonis mali plod (Adonis microcarpa DC), Ščitasti rman (Achillea clypeolata).**

Opis: Umetnička reprezentacija cveća (slikarstvo, crtež, grafika u boji ili umetnička fotografija).

Nagrada: Prvo mesto € 400; drugo mesto 300 €; treće mesto 200 €; četvrto mesto 170 € i peto mesto 150 €.

10. Tematska poštanska marka: **"Fauna - Ptice Kosova"**.

Opis: Umetnička reprezentacija vrsta: Čvorak (Sturnus vulgaris), Gnjurci (Podiceps cristatus), Ptica Grabljivica (Falco tinnunculus), Zlatna vuga (Oriolus), Grlica (Streptopelia turtur), Pupavac (Upupa epops) – (crtež, grafika, umetnička fotografija, slikarstvo).

Nagrada: Prvo mesto € 400; drugo mesto 300 €; treće mesto 200 €; četvrto mesto 170 € i peto mesto 150 €.

11. Tematska poštanska marka: **"20. godišnjica slave - porodica Jashari"**.

Opis: Umetnička reprezentacija otpora i herojskog rata porodice Jašari (crtež, grafika, umetnička fotografija, slikarstvo).

Nagrada: Prvo mesto € 400; drugo mesto 300 €.

12. Tematska poštanska marka: **"Nasleđe - drevna lokacija Dresnika "**

Opis: Umetnička reprezentacija arheoloških otkrića u Dresniku (crtež, grafika, umetnička fotografija, slikarstvo).

Nagrada: Prvo mesto € 400; filatelistički blok € 500.

13. Tematska poštanska marka: **"Rukotvorina - gline radovi"**.

Opis: Umetnička reprezentacija glinenih radova (crtež, grafika, umetnička fotografija i slikarstvo).

Nagrada: Prvo mesto € 400; drugo mesto 300 €; treće mesto 200 €.

PRAVILA KONKURENCIJE:

- Umetnički dizajn zasnovan na ovim temama treba uraditi u specijalizovanim dizajnerskim programima (Adobe Photoshop, Illustrator, Corel Draw ili grafičke slike, fotografije, lični crteži itd.); isto treba dostaviti ispisanim u kompjuterskom dosijeu.
- Rad sa rezolucijom manja od 500 px (TIFF ili PDF) neće biti prihvaćena.
- Ime autora dizajna ne treba pisati pored konkurentskog motiva, tamo treba biti samo cifre.
- Konkurentni dizajn ovog konkursa mora se dostaviti u zatvorenom kovertu.

- Jedan autor se može takmičiti sa neodređenim brojem radova, ali sa različitim cifrenim kodovima za svaki program poštarine.
- Štampani konkurentni radovi sa CD-om treba da budu stavljeni u kovertu, koji takođe treba da sadrži zatvorenu kovertu sa autorskim informacijama.
- Konkurentni radovi za različite programe poštarine treba pakovati zasebno; označavajući naziv programa za koji se nadmećete i cifru.
- Nosioc autorskih prava na dizajnu (konkurent) će imati odgovornost za autorsko pravo.

Iz razloga poverljivosti i objektivnosti, na spoljnom delu koverata i na CD-u treba označiti samo cifru koju je izabrao autor (nigde drugde u radovima ne sme se pojaviti ime ili prezime autora, već samo cifra).

Komisija Pošte pri izboru dizajna neće imati pristup beleškama o autorskim pravima, ali ima pravo da potvrdi autentičnost izabranih dizajna.

PK Sh.A. snosiće poreske obaveze.

KONKURENCIJA će biti otvorena 40 kalendarskih dana, od 20.09.2017 do 30.10.2017 i biće objavljena na veb sajtu www.postakosoves.com.

Konkurentni radovi neće biti vraćeni autorima.

Izbor najboljih konkurentnih radova, na osnovu najboljeg dizajna i dodele nagrada, donosi Komisija za Poštanske Marke.

Radovi se moraju dostaviti ili poslati na ovu adresu:

FILATELIA

Za Konkurs - Filatelija

Zgrada Pošte Kosova bb

Kosovo Polje 12000

Republika Kosova

Za dodatne informacije možete se obratiti na broj telefona: +381 (0) 38 246 770 ili nas kontaktirati na e-mail adresu: ptkfilatelia@ptkonline.com ili na službenom veb sajtu www.postakosoves.com.